REZOLUTË

a) Duke ndjekur në vazhdimësi marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Bashkimit Europian dhe zhvillimin e negociatave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe duke përshëndetur angazhimin e BE-së dhe të strukturave të tij në Bruksel e në Tiranë për kontributin e çmuar në këtë proces;

b) Duke evidentuar përpjekjet dhe progresin e bërë nga Shqipëria përmes hapjes zyrtare dhe zhvillimit të negociatave me BE-në për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit;

c) Duke konsideruar si realiste, nxitëse dhe programore qëndrimet kritike të BE-së në lidhje me mundësitë që ofron vendi ynë për garantimin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe nevojën për të përshpejtuar zbatimin e rekomandimeve të tij;

ç) Duke vlerësuar progresin relativ lidhur me stabilitetin politik dhe reformën zgjedhore, duke shprehur shqetësimin për konstatimet në raport se korrupsioni i përhapur dhe krimi i organizuar janë kërcënues për stabilitetin dhe se progresi i bërë në administratën publike është dëmtuar në disa raste të emërimeve politike dhe nepotike;

d) Duke shprehur shqetësimin për moszbatimin e Kushtetutës për kthimin dhe kompensimin e pronës private, që ka sjellë edhe mungesën e një tregu funksional për tokën e kapitalet dhe duke njohur se ka akoma hapësirë për përmirësimin në respektimin e të drejtave të njeriut;

dh) Duke vlerësuar mbajtjen nën kontroll të treguesve kryesorë makro-ekonomikë dhe të shqetësuar për uljen në rritjen ekonomike e në rendimentin financiar, krizën energjetike dhe mosrealizimet në procesin e privatizimit;

e) Duke njohur progresin zyrtar në kuadrin e stabilizim-asocimit, si dhe nevojën për më tepër përpjekje konkrete dhe të vendosura që Shqipëria duhet të tregojë për të konkluduar me sukses negociatat për stabilizim-asocimin;

ë) Duke vlerësuar se bashkëpunimi politik dhe institucional i të gjithë faktorëve është i domosdoshëm për zhvillimin e reformave afatgjata e integruese;

f) Në vazhdim të mbështetjes që i ka dhënë hapjes dhe vazhdimit të negociatave Shqipëri-BE për MSA;

g) Bazuar në rekomandimet e bëra nga Komisioni i BE-së në raportin e tij vjetor në adresë të të gjithë faktorëve institucionalë shqiptarë në procesin e integrimit europian,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. I kërkon Qeverisë, në bashkëpunim me institucionet, forcat politike dhe shoqërinë civile, të shndërrojë Planin Strategjik për Integrim në Strategji Kombëtare për Integrim në Bashkimin Europian, i cili të detajojë, brenda muajit qershor 2003, të gjithë hapat që do të ndërmerren në përmbushje të të gjitha detyrimeve, si dhe plotësimin e standardeve që rrjedhin nga procesi i integrimit në fushën e reformave dhe përafrimit të legjislacionit.

2. I kërkon Qeverisë dhe forcave politike të përfaqësuara në Kuvend, si dhe institucioneve të tjera përkatëse që, mbi bazën e propozimeve konkrete të bëra në Kuvend, veçanërisht nga opozita, brenda një periudhe 2-3 mujore, të marrin të gjitha masat administrative dhe nismat ligjvënëse për zgjidhje të përshpejtuar të çështjeve që lidhen me luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe reformën institucionale, të domosdoshme për shpejtimin e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

3. I kërkon Qeverisë dhe institucioneve të tjera konkretizimin dhe intensifikimin e përshpejtuar të proceseve të veprimit në fusha prioritare, si lufta kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme, korrupsionit, sidomos në fushat kyçe të sistemit gjyqësor, doganave dhe policisë, për të përmbushur kështu objektivat prioritarë në këtë drejtim, që kërkojnë vëmendje serioze 12 muajt e ardhshëm.

4. I kërkon Qeverisë të prezantojë në Kuvend programin e veprimeve për shpejtimin e reformës strukturore në ndërmarrjet e mëdha dhe ato strategjike, sidomos në sektorin financiar, për të përmirësuar legjislacionin tregtar në dobi të forcimit të konkurrencës dhe minimizimin e ekonomisë informale, për të rritur performancën në sektorët kyç të ekonomisë, si dhe mbledhjen e të ardhurave nga administrata fiskale.

5. Mbështet Presidentin e Republikës të ndërmarrë nisma konkrete dhe rezultative për reformën në drejtësi, me synim garantimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe luftën kundër korrupsionit.

6. Kërkon nga gjyqësori dhe prokuroria të zbatojnë me korrektësi ligjin kundër krimit dhe trafiqeve të paligjshme, si dhe të mundësojnë dhënien e drejtësisë sipas ligjit për të gjithë shtetasit.

7. U kërkon institucioneve të tjera kushtetuese, Avokatit të Popullit dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, të kryejnë detyrat e tyre në forcimin e institucioneve, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi.

8. U bën apel partive politike të Shqipërisë të kontribuojnë në përmirësimin dhe forcimin e frymës së dialogut politik, bashkëpunimin institucional, garantimin e stabilitetit politik në vend dhe përfundimin me sukses të procesit të reformës zgjedhore.

9. Nxit përshpejtimin e reformës në administratën publike, në përputhje me ligjin "Për shërbimin civil", duke forcuar institucionet përgjegjëse, duke zgjeruar fushën e zbatimit të këtij ligji dhe garantuar zbatimin e kritereve të tij në emërimet në administratë.

10. Rikonfirmon vullnetin për mbështetje legjislative dhe kontroll parlamentar për zbatimin e rekomandimeve të BE-së, veçanërisht në fushën e reformave ekonomike, zgjidhjen ligjore përfundimtare të kthimit dhe kompensimit të pronave, në përputhje me Kushtetutën dhe garantimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe minoriteteve.

Tiranë, më 17 prill 2003